

Nr. 9937



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MIRËQENIES  
SOCIALE DHE RINISË  
MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 17, datë 30.08.2016

MBI

ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 07.09.2006, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE  
MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”  
TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 27 të Vendimit Nr. 618, datë 07.09.2006, "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar:

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM, Nr. 618, datë 07.09.2006 të ndryshuar, bëhet 10.140 (dhjetëmijë e njëqind e dyzetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM, Nr. 618, datë 07.09.2006 të ndryshuar, bëhet 10.140 (dhjetëmijë e njëqind e dyzetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10.650 (dhjetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.
3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 Shtatori i vitit 2016 dhe përballohen me fondet akorduar për vitin 2016, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
4. Udhëzimi nr. 22, datë 20.08.2015 i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 01.09.2016.

Blendi Klosi  
MINISTER